



Npi – 01/162 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenet 11, 12.2 pika (d) si dhe nenin 17 pika (k), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); - Nenin 5 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; - Nenet 13.2 dhe 13.3 si dhe nenin 14.1 të Rregullores Komunale për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, me numër: Npi – 01/77 të datës 28.03.2019, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 27.04.2023 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË SHUMËN PREJ 250 €

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 27.04.2023, unanimisht miratoi Vendimin për caktimin e çmimit në vlerë prej 250 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët që varrosen në territorin e kufijve administrativë të Komunës së Shtimes.

II

Pagesa për qytetarët e komunitetit fetar Islam procedohet përmes Këshillit të Bashkësisë Islame – KBI në Shtime, mbi bazën e marrëveshjes dypalëshe që do të lidhet pas miratimit të këtij Vendimi.

III

Për qytetarët e komuniteteve të tjera fetare (ose për ata që nuk i përkasin asnjë komuniteti fetar), pagesa e shpenzimeve të varrimit bëhet sipas kërkesës nga familjarët e personave që ndërrojnë jetë.

IV


Pagesa për shpenzimet e varrimit të veteranëve dhe invalidëve të Luftës së UÇK-së bëhet sipas nenit 14.4 të Rregullores me numër Npi – 01/77 e datës 28.03.2019 për Varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

VI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës Komunale për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi